

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Italia ndalon burkat në shkolla
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/italia-ndalon-burkat-ne-shkolla-i475238
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:54:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3fc166d2e640f8721bcc83586ad24bc73888d51fd74f7e0421cd85f2cde77707
TEKSTI	9275a0dc6400d8895a4ed7bb48531b9ee210f52d48a5968fa27ab7be164a9e88
PAMJA	600434bee5675929351578220a4142b27de5c8b2f96a2405ec8783280d80eb1c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b18d33f1a4adddcb6e18f77c6ca1a0c06e361fcf81898d26abdb17341fae633
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/b18d33f1a4adddcb6e18f77c6ca1a0c06e361fcf81898d26abdb17341fae633

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

08:18 Kosova & Bota

Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, tha se vendi i...

Italia ndalon burkat në shkolla



26 Shtator 2026, 08:47, Kosova & Bota CNA



Qeveria e krahut të djathtë e Italisë ka ndaluar veshjet që mbulojnë fytyrën në shkolla. Ekzistojnë edhe rregulla të reja për prindërit dhe nxënësit me njohuri të kufizuara të gjuhës italiane.

Në të ardhmen, shkollat italiane do të ndalojnë mbulimin e fytyrës. Përveç kësaj, që nga viti i ardhshëm shkollor, një maksimum prej 30 përqind e nxënësve në një klasë do të jenë të huaj me njohuri të pamjaftueshme të gjuhës italiane, njoftoi qeveria në Romë.

"Organizimi i klasave në mënyrë që ato të jenë, le të themi, të balancuara, është një instrument që u sjell dobi të gjithëve dhe inkurajon integrimin", tha kryeministrja Giorgia Meloni për transmetuesin publik RAI më 25 shtator.

Ajo njoftoi rregullat kontroverse javën e kaluar në një aktivitet rinor të partisë së saj të krahut të djathtë Fratelli d'Italia ("Vëllezërit e Italisë"). Tani kabineti i saj ka miratuar masat me dekret.

Meloni ka udhëhequr qeverinë e koalicionit të Italisë të partive të krahut të djathtë dhe konservatore që nga viti 2022. Në atë kohë, politikania 49-vjeçare bëri fushatë me sukses me premtimin e një qëndrimi të ashpër ndaj emigrantëve. Përjashtime nga limiti prej 30 përqind

Dekreti synon kryesisht nxënësit e sapoardhur. Në klasat e para, kuota prej 30 përqind do të përfshijë fëmijët që nuk kanë shtetësi italiane, nuk kanë lindur në Itali dhe nuk kanë ndjekur të paktën dy vjet kopsht italian.

Në arsimin fillor, të njëjtat rregulla zbatohen për klasat e larta dhe shkollat ??e mesme, por në vend të dy viteve në kopsht, nxënësit do të duhet të kenë ndjekur të paktën tre vjet në shkollat ??italiane për t'u përjashtuar nga kuota prej 30 përqind.

Dekreti gjithashtu thotë se mbulesat e fytyrës nuk lejohen dhe se fytyra duhet të jetë e dallueshme. Kjo ka të ngjarë të zbatohet kryesisht për mbulesat e fytyrës si burka dhe nikabi. Qeveria nuk tha se sa fëmijë mund të preken nga ky rregull.

Edhe prindërit duhet të mësojnë italisht

Rregullat e reja nuk zbatohen vetëm për fëmijët. Prindërit me vështirësi të konsiderueshme gjuhësore do të duhet të ndjekin gjithashtu kurse të gjuhës italiane nëse nuk mund të komunikojnë mirë me shkollën.


Dekreti kërkon që shkollat ??të njoftojnë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve kur identifikojnë vështirësi serioze gjuhësore midis prindërve. Shërbimet sociale do të jenë në gjendje të ofrojnë kurse falas të gjuhës italiane.

Ata që nuk i përmbahen rregullave të reja do të përballen me gjoka. Mediat italiane njoftojnë se prindërit mund të gjobiten midis 200 dhe 1,000 euro.

Gjobat

Sektori i arsimit është kritikuar tashmë për vështirësitë në zbatimin e masave në praktikë. Një sindikatë e ka përshkruar dekretin si "propagandë", duke thënë se nuk i adreson problemet reale në arsim.

Italia do të mbajë zgjedhje vitin e ardhshëm. Sondazhet tregojnë se partia Fratelli d'Italia e Melonit ende kryeson sondazhet. Megjithatë, në javët e fundit, koalicioni i saj i krahut të djathtë është vënë nën presion në rritje nga partia e re Futuro Nazionale ("E Ardhmja Kombëtare") e ish-gjeneralit Roberto Vanacci. Kjo parti është pozicionuar edhe më djathtas dhe bën thirrje për masa edhe më të rrepta kundër migracionit./ DW





Të sugjeruara

Partitë ekstremiste po lulëzojnë dhe kjo i tremb njerëzit

Irani i propozon marrëveshje SHBA-së për të rihapur Ngushticën e Hormuzit brenda shtatë ditësh

Kishte destinacion Kosovën/ Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar

U qëllua me armë gjatë një tubimi të Trump në Pensilvani/ 76-vjeçari humb jetën pas dy vitesh

Bundestagu gjerman miraton zbritjen e taksës së karburantit

Në disa qytete të Kosovës protestohet kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Nisma për ndryshimin e ligjit të "Speciales" dërgohet për mendim në Qeveri

Takimi Trump-Xi: Fanfara, paradë, bankete dhe pak rezultate

Greqia po përpiqet të rikthejë punëtorët e kualifikuar

Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?

Dyshohet për krime në kampin nazist të të burgosurve të luftës/ Nisin hetimet ndaj 105-vjeçarit në Gjermani

FOTO/ Dhjetëra delegatë braktisin sallën e OKB-së sapo Netanyahu merr fjalën

I shiti Pentagonit softuer për hakimin e telefonave/ Kompania rezulton me pronësi ruse

Rekord i ri për vitin 2026/ Ja sa emigrantë kanë kaluar brenda një dite Kanalin Anglez

Rikthimi i Turqisë në programin F-35/ Erdogan: Trump është pozitiv për këtë perspektivë

[Takim Trump-Putin në dhjetor?/ Reagon Kremlini, ja çfarë mund të ndodhë](#)

[Pas bisedimeve me SHBA-në/ Lukashenko liron 15 të burgosur politikë](#)

[Çfarë strategjie mund të ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?](#)

[Inteligjenca Artificiale në fokus/ Çfarë deklaruan Trump dhe Xi Jinping në Shtëpinë e Bardhë](#)


[Gjermania dyfishon parashikimin e rritjes ekonomike për vitin 2026](#)

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

[Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!](#)

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

[Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH](#)

[opinion](#)

07:33 Opinione Sadik Bejko

Rasputin, patronazhizmi seksual

21:28 Opinione Erion Dasho

SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?

20:15 Opinione Ilnisa Agolli

Një spiune me moralin e Vlora Hysenit

Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.